



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.150

11 nëntor

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr.797, datë 29.9.2010

Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare “Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”..... 7997

Vendim i KM
nr.846, datë 27.10.2010

Për një shtesë në vendimin nr.862, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai vendor”..... 8010

VENDIM
Nr.797, datë 29.9.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES HIGJIENO-SANITARE “PËR ADMINISTRIMIN E CILËSISË SË UJËRAVE TË LARJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 “Për shëndetin publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, të ndryshuar dhe të pikës 4 të nenit 42 të ligjit nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë”, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore higjieno-sanitare “Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi, në përfrim me direktivën 2006/7/KE të Parlamentit dhe të Këshillit të Europës, të datës 15 shkurt 2006, për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes, që shfuqizon direktivën 76/160/KEE.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe autoritetet e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

3. Rregullorja nr.3, datë 4.5.1989 “Për kushtet higjieno-sanitare të plazheve dhe vendeve të larjes në lumë” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE HIGJIENO-SANITARE
“PËR ADMINISTRIMIN E CILËSISË SË UJËRAVE TË LARJES”

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është:

1. Vendosja e kriterëve shëndetësore që duhet të plotësojnë ujërat e larjes për të siguruar cilësinë e tyre, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të çdo lloj ndotjeje.

2. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit në plotësim të direktivës 2000/60/KE.

3. Vendosja e dispozitave për monitorimin, klasifikimin dhe menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes dhe informimin e publikut mbi të.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore aplikohet për ujërat e larjes, sipas përcaktimit në nenin 3, pika 1.

2. Kërkesat e kësaj rregulloreje nuk zbatohen për:

a) pishinat dhe pishinat me ujëra termale/llixha;

b) ujërat e rrethuara në mënyrë natyrale apo artificiale, që janë objekt i trajtimit apo për përdorim për qëllime kurative;

c) ujërat e rrethuara në mënyrë artificiale dhe të ndara nga ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. Ujërat e larjes: çdo element i ujit sipërfaqësor ku autoriteti kompetent pret të ketë një numër të madh njerëzish për t'u larë dhe ku nuk ka vendosur ndalim të përhershëm për t'u larë apo rekomandim të përhershëm për të mos u larë.

2. Ujërat sipërfaqësore: ujërat e brendshme, me përjashtim vetëm të ujërave nëntokësore; ujërat kalimtare dhe ujërat bregdetare, përveç rasti të gjendjes kimike për të cilën përfshihen edhe ujërat territoriale.

3. Ujërat nëntokësore: të gjitha ujërat, të cilat janë nën sipërfaqen e tokës në zonën e ngopjes dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me tokën ose tabanin.

4. Ujërat e brendshme: të gjitha ujërat e ndenjura ose të rrjedhshme në sipërfaqen e tokës, dhe të gjitha ujërat nëntokësore në anën nga toka të vijës bazë që shërben për të matur gjerësinë e ujërave territoriale.

5. Ujërat kalimtare: trupat ujorë sipërfaqësorë në afërsi të grykës së lumit, të cilat janë pjesërisht të kripur si rezultat i afërsisë së tyre me ujërat bregdetare, por që janë kryesisht të ndikuara nga rrjedhjet e ujërave të ëmbla.

6. Ujërat bregdetare: ujërat sipërfaqësore, në anën nga toka të një vije, çdo pikë e së cilës është në një largësi prej një milje detare në anën nga deti prej pikës më të afërt të vijës bazë që shërben për të matur gjerësinë e ujërave territoriale, duke u zgjeruar sipas nevojës deri në kufirin e jashtëm të ujërave kalimtare.

7. Trup ujor sipërfaqësor: një element i veçantë dhe i rëndësishëm i ujërave sipërfaqësore, si një liqen, rezervuar, rreke, lum apo kanal, pjesë e një rrekeje, lumi apo kanali, një ujë kalimtar ose një brez i ujit bregdetar.

8. Pellgu ujëmbledhës: sipërfaqja e tokës prej së cilës e gjithë rrjedhja sipërfaqësore prej një serie përrenjsh, lumenjsh dhe ndoshta liqenesh, derdhet në det nga një grykë e vetme lumi, estuar ose deltë.

9. Autoritet kompetent

a) Inspektorati Sanitar Shtetëror (ISSH) në kuadër të çdo rrethi, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), i ngarkuar me detyrën e garantimit të plotësimit të kërkesave shëndetësore të kësaj rregulloreje.

b) Inspektorati i Mjedisit (IM) në kuadër të çdo rajoni, në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU), i ngarkuar me detyrën e garantimit të plotësimit të kërkesave mjedisore të kësaj rregulloreje.

c) Pushteti vendor në kuadër të çdo rrethi, i ngarkuar me detyrën e garantimit të përputhjes me masat menaxhuese të parashikuara në këtë rregullore dhe që nuk janë mbuluar në seksionet a) dhe b).

d) Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) dhe çdo organ relevant, brenda fushës së vet të kompetencave.

10. Ndotje: prezenca e ndotjes mikrobiologjike apo organizmave të tjerë, e mbetjeve ose lëndëve kimike, siç përcaktohet në nenet 10 e 11 dhe në shtojcën I, kolona A, që ndikojnë në cilësinë e ujit të larjes dhe paraqesin një rrezik për shëndetin e njerëzve që lahen në to.

11. Ndotje afatshkurtër: ndotje mikrobiologjike siç përcaktohet në shtojcën I, kolona A për shkaqe qartësisht të identifikuar dhe kur parashikohet që cilësia e ujërave të larjes të mos ndikohet për më shumë se 72 orë nga momenti i parë që është zbuluar ndotja dhe për të cilën IM-ja ka përcaktuar procedurat e nevojshme për parashikimin dhe përbalimin, siç përcaktohet në shtojcën II.

12. Vlerësimi i cilësisë së ujit të larjes: procesi i përvitshëm i vlerësimit të ujit të larjes, duke përdorur metodën vlerësuese të përcaktuar në shtojcën II.

13. Masa administruese: masat e mëposhtme që ndërmerren për sa u përket ujërave të larjes:

a) krijimi dhe ruajtja e një profili të ujërave të larjes;

b) krijimi i një kalendari monitorimi;

c) monitorimi i ujërave të larjes;

d) vlerësimi i cilësisë së ujërave të larjes;

e) klasifikimi i ujërave të larjes;

f) identifikimi dhe vlerësimi i shkaqeve të ndotjes që mund të ndikojnë mbi ujërat e larjes dhe dëmtojnë shëndetin e njerëzve që lahen;

g) informimi i publikut sipas nenit 14;

h) marrja e masave për të parandaluar ekspozimin ndaj ndotjes të njerëzve që lahen;

i) marrja e masave për të reduktuar rrezikun e ndotjes;

j) marrja e masave për të eliminuar shkaqet e ndotjes dhe për të përmirësuar cilësinë e ujërave të larjes.

14. Numër i madh: lidhur me personat që lahen në ujërat e larjes, numri që autoriteti kompetent e konsideron të jetë i madh, duke marrë parasysh veçanërisht prirjet e mëparshme, ose infrastrukturën apo shërbimet e ofruara, ose masa të tjera të marra për promovimin e larjes;

15. Ndalim i përhershëm për t'u larë ose rekomandim i përhershëm për të mos u larë: kur një ndalim ose rekomandim zgjat për të paktën një sezon të plotë larjeje;

16. Shumëzimi i cianobakterieve: një grumbullim i cianobakterieve në formën e lulëzimit, shtresës ose shkumës.

17. Publiku: një ose më shumë persona fizikë ose juridikë dhe shoqatat, organizatat ose grupet e tyre, të krijuara në pajtim me praktikat ose legjislacionin kombëtar;

18. Publiku i interesuar: publiku i prekur ose që mund të preket nga procedurat vendimmarrëse për çështjet e mjedisit ose ka interes në këto procedura; për qëllim të këtij përkufizimi, organizatat joqeveritare që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe përmbushin kërkesat e legjislacionit kombëtar në fuqi, konsiderohen se kanë interes;

19. Pika e monitorimit: vendi i caktuar nga ISSH-ja për marrjen e kampionëve me qëllim monitorimin e cilësisë së ujit të larjes, e lokalizuar në brendësi të ujit të larjes, aty ku parashikohet numri më i madh i personave që lahen në të ose rreziku më i lartë i ndotjes në bazë të profilit të ujit të larjes. Çdo ujë i larjes duhet të ketë të paktën një pikë monitorimi.

20. Seria e të dhënave të cilësisë së ujërave të larjes: të dhënat e përftuara në përputhje me nenin 5;

21. Incidente: ato që përshkruhen më poshtë:

a) situatë jonormale: një ngjarje ose kombinim i ngjarjeve që ndikojnë cilësinë e ujit të larjes në vendin në fjalë, që pritet të ndodhë jo më shumë se një herë në çdo katër vjet.

b) rrethanë e jashtëzakonshme: një situatë e papritur që ka ose mund të ketë efekt të dëmshëm në cilësinë e ujit të larjes dhe në shëndetin e personave që lahen në të.

22. Sezoni i larjes: periudha gjatë së cilës pritet të ketë një numër të madh të personave që lahen në ujërat e larjes.

Neni 4

Kompetencat e institucioneve qendrore dhe e pushtetit vendor

1. Kompetencat e institucioneve qendrore dhe pushtetit vendor janë:

a) funksioni i drejtimit, promocionit, këshillimit dhe koordinimit të aktiviteteve lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje;

b) përditësimi dhe integrimi i tabelave dhe standardeve teknike bashkëngjitur, në bazë të arritjeve të reja shkencore dhe teknike ose për të përmirësuar cilësinë e ujërave të larjes;

c) përpunimi i të dhënave të monitorimit;

d) identifikimi i ujërave të larjes dhe pikave të monitorimit. Ujërat e larjes të identifikuar regjistrohen në regjistra të veçantë;

e) përcaktimi dhe përditësimi i profilit të ujërave të larjes, siç është përcaktuar në shtojcën III;

f) përcaktimi i një kalendari monitorimi para fillimit të çdo sezoni larjeje;

g) klasifikimi i ujërave të larjes sipas nenit 7;

h) e drejta për të zgjatur ose shkurtuar sezonin e larjes, sipas nevojave apo rregullave lokale;

i) përditësimi i listës së ujërave të larjes;

j) marrja e masave për eliminimin e shkaqeve të ndotjes dhe përmirësimin e ujërave të larjes;

k) rrethimi, para fillimit të sezonit të larjes, i ujërave që nuk janë të destinuar për larje dhe ujërat e larjes të ndaluara përgjithmonë për larje, që bien në territorin përkatës;

l) rrethimi i zonave të ndaluara për larje, në qoftë se gjatë sezonit të larjes verifikohet një rrethanë e jashtëzakonshme;

m) tërheqja e masave të mara në bazë të dispozitave të përmendura në gërmat “k” e “l”;

n) vendosja në zonat e interesuara, në një vend të dukshëm, sa më në afërsi të secilit ujë të larjes, të shenjave që tregojnë ndalimin e larjes, sipas pikës 1, gërmat “c”, “e” e “f” të nenit 14;

o) sinjalizimi në një vend të dukshëm, sa më në afërsi të secilit ujë të larjes, i parashikimeve të ndotjeve me kohëzgjatje të shkurtër, sipas pikës 2, gërma “c” e nenit 14;

p) informimi i publikut në bazë të nenit 14.

2. Kompetencat sipas pikës 1, ushtrohen:

i) për gërmat “a”, “b” e “c”, nga MSH-ja;

ii) për gërmat “d”, “i”, “k” e “p”, nga ISSH-ja dhe pushteti vendor;

iii) për gërmat “e”, “f” e “g”, nga ISSH-ja;

iv) për gërmën “h”, nga pushteti vendor;

v) për gërmën “j”, nga pushteti vendor dhe MMPAU-ja;

vi) për gërmat “l”, “m”, “n” e “o”, nga pushteti vendor.

ISSH-ja, në përputhje me mënyrat e përcaktuara në këtë rregullore, i transmeton MSH-së rezultatet e monitorimit dhe informacionin, sipas gërmave “g” dhe “j” të pikës 1, brenda 30 nëntorit të çdo viti, si dhe informacionin, sipas gërmave “d”, “e”, “f”, “h” dhe “i” të pikës 1, brenda 1 marsit të çdo viti. Në vijim, MSH-ja i transmeton MMPAU-së informacionet, sipas gërmave “d” dhe “j”, brenda 30 dhjetorit të çdo viti dhe sipas gërmave “f” dhe “p” të pikës 1, brenda 1 prillit të çdo viti.

KAPITULLI II CILËSIA DHE ADMINISTRIMI I UJËRAVE TË LARJES

Neni 5 Monitorimi

1. ISSH-ja dhe pushteti vendor identifikojnë çdo vit të gjitha ujërat e larjes. MTKRS-ja dhe pushteti vendor përcaktojnë kohëzgjatjen e sezonit të larjes. Këto realizohen për herë të parë para fillimit të sezonit të parë të larjes pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

2. ISSH-ja siguron që monitorimi i parametrave të përcaktuar në shtojcën I, kolona A, të realizohet në përputhje me shtojcën IV. Programi i parë i monitorimit të parametrave të përcaktuar në shtojcën I, kolona A, kryhet gjatë sezonit të parë të plotë të larjes pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Rezultatet e këtij monitorimi mund të përdoren për të krijuar serinë e të dhënave mbi cilësinë e ujërave të larjes sipas nenit 6.

3. Pika e monitorimit përcaktohet në brendësi të çdo uji të larjes ku parashikohet:

a) numër i madh i personave që lahen në të; ose

b) rrezik më i madh i ndotjes në bazë të profilit të ujit të larjes.

4. Për secilin ujë të larjes, ISSH-ja përcakton një kalendar monitorimi para fillimit të çdo sezoni të larjes dhe për herë të parë para fillimit të sezonit të larjes pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Marrja e kampionëve kryhet jo më vonë se katër ditë pas datës së specifikuar në kalendarin e monitorimit.

5. Kampionët e marrë gjatë ndotjes afatshkurtër mund të mos merren në konsideratë për qëllim të vlerësimit sipas nenit 6 dhe të zëvendësohen me kampionët e marrë në përputhje me shtojcën IV.

6. Gjatë situatave jonormale, kalendarin e monitorimit i përmendur në paragrafin 4, mund të pezullohet. Ai rifillon menjëherë pas përfundimit të situatës jonormale, duke marrë kampionë të rinj për të zëvendësuar kampionët që mungojnë për shkak të situatës jonormale.

7. ISSH-ja i raporton MSH-së çdo pezullim të kalendarit të monitorimit, duke paraqitur arsyet përkatëse. MSH-ja bën me dije MMPAU-në.

8. ISSH-ja siguron që analizat e cilësisë së ujërave të larjes të realizohen në përputhje me metodat e referimit të përcaktuara në shtojcën I dhe procedurat e përcaktuara në shtojcën V. Megjithatë, MSH-ja mund të lejojë përdorimin e metodave apo rregullave të tjera, në rast se argumenton se rezultatet e përfutuara janë të barasvlershme me rezultatet e përfutuara nga metodat e përcaktuara në shtojcën I dhe procedurat e përcaktuara në shtojcën V.

9. Rezultatet e monitorimit, të kryer, të paktën me shpeshtësinë e treguar në shtojcat e kësaj rregulloreje, i transmetohen menjëherë MSH-së, MMPAU-së dhe pushtetit vendor, për qëllim të dispozitave të nenit 13, pika 2 e 3 dhe nenit 14, pika 3.

Neni 6

Vlerësimi i cilësisë së ujërave të larjes

1. ISSH-ja siguron që seria e të dhënave të cilësisë së ujërave të larjes përfitohet nëpërmjet monitorimit të parametrave të përcaktuar në shtojcën I, kolona A.

2. ISSH-ja kryen një vlerësim vjetor të cilësisë së ujërave të larjes:

a) për çdo pikë monitorimi të ujit të larjes;

b) pas përfundimit të çdo sezoni larjeje;

c) mbi bazën e serisë së të dhënave të cilësisë së ujërave të larjes të sezonin të larjes në fjalë dhe tri sezoneve të mëparshme të larjes;

d) në përputhje me procedurën e përcaktuar në shtojcën II.

3. MSH-ja mund të vendosë që vlerësimi sipas pikës 2, germa "c", i cilësisë së ujërave të larjes, t'i referohet vetëm tri sezoneve të mëparshme të larjes. Periudha e zbatuar e vlerësimit nuk mund të ndryshojë më shumë se një herë në çdo pesë vjet.

4. Seria e të dhënave të ujërave të larjes, e përdorur për të realizuar vlerësimet përkatëse të cilësisë së ujërave të larjes, përmban të paktën 16 kampionë, ose në rrethana të veçanta sipas shtojcës IV, paragrafi 2, përmban 12 kampionë.

5. Megjithatë, duke pranuar se janë plotësuar kërkesat e pikës 4 ose seria e të dhënave të ujërave të larjes, të përdorura për vlerësim përmban të paktën 8 kampionë, në rastin e ujërave të larjes me një sezon larjeje që nuk i kalon 8 javë, vlerësimi mund të kryhet mbi bazën e një serie të dhënash që i përket më pak se katër sezone larjesh në rast se:

a) uji i larjes është identifikim i ri;

b) janë verifikuar ndryshime të tilla, që mund të ndikojnë mbi klasifikimin e ujërave të larjes sipas nenit 7. Në këtë rast, vlerësimi kryhet mbi bazën e një serie të të dhënave mbi cilësinë e ujërave të larjes, që konsiston vetëm në rezultatet e kampionëve të mbledhur që nga koha kur janë verifikuar ndryshimet;

c) ujërat e larjes janë tashmë të vlerësuar sipas direktivës 76/160/KEE. Në këtë rast, parametrat 2 dhe 3 të shtojcës së direktivës 76/160/KEE, gjykohen të barasvlershëm me parametrat 2 dhe 1 të kolonës A të shtojcës I të kësaj rregulloreje.

6. ISSH-ja mund të nënndajë ose grupojë ujërat e larjes ekzistuese, duke marrë parasysh vlerësimet e cilësisë së ujërave të larjes. Ata mund t'i grupojnë ujërat e larjes ekzistuese vetëm në rast se ujërat në fjalë:

- a) përputhen;
- b) kanë marrë vlerësime të ngjashme në katër vitet e mëparshme sipas pikave 2, 4 dhe 5 (c);
- c) kanë profile të ujërave të larjes që identifikojnë faktorë të njëjtë rrezikshmërie ose mungesë të njëjtë të tyre.

Neni 7

Klasifikimi dhe statusi i cilësisë së ujërave të larjes

1. Në vijim të vlerësimit të cilësisë së ujërave të larjes, të realizuar sipas nenit 6, ISSH-ja, në përputhje me kriteret e përcaktuara në shtojcën II, i klasifikon ujërat e larjes si ujëra të cilësisë:

- a) “së keqe”;
- b) “të mjaftueshme”;
- c) “të mirë”;
- d) “të shkëlqyer”.

2. Klasifikimi i parë sipas kërkesave të kësaj rregulloreje plotësohet deri në fund të sezonit të larjes të vitit 2012.

3. Pushteti vendor, MMPAU-ja dhe MPPT-ja duhet të sigurojnë që, deri në fund të sezonit të larjes të vitit 2015, cilësia e gjithë ujërave të larjes të jetë të paktën “e mjaftueshme”. Ata duhet të ndërmarrin masa të tilla të përshtatshme për rritjen e numrit të ujërave të larjes të klasifikuar si “të shkëlqyer” ose “të mirë”.

4. Pavarësisht nga kërkesa e përgjithshme e pikës 3, ujërat e larjes mund të klasifikohen përkohësisht si ujëra të cilësisë “së keqe”. Në këtë rast, autoriteti kompetent siguron që plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) për çdo ujë të larjes të klasifikuar si i cilësisë “së keqe”, ndërmerren masat e mëposhtme me efekt veprimi nga sezoni i larjes që pason klasifikimin në fjalë:

- i) masa të duhura administrative, përfshirë ndalimin e larjes ose rekomandim për të mos u larë me qëllim parandalimin e ekspozimit ndaj ndotjes të personave që lahen në ujërat e larjes;
- ii) përcaktimi i shkaqeve dhe arsyeve për mosarritjen e statusit të cilësisë “e mjaftueshme”;
- iii) masa të duhura për të parandaluar, reduktuar ose eliminuar shkaqet e ndotjes;
- iv) sipas nenit 14, paralajmërimi i publikut me anë të një sinjali paralajmërues të thjeshtë dhe të qartë dhe informimi i tij mbi shkaqet e ndotjes dhe masat e ndërmarra në bazë të profilit të ujit të larjes.

b) Në rast se ujërat e larjes klasifikohen si të cilësisë “së keqe” për pesë vite të njëpasnjëshme, ISSH-ja vendos një ndalim të përhershëm të larjes ose një rekomandim të përhershëm kundër larjes. Megjithatë, ISSH-ja mund të vendosë një ndalim të përhershëm të larjes ose një rekomandim të përhershëm kundër larjes, që pas përfundimit të vitit të dytë të cilësisë “e keqe”, në rast se ai gjykon se arritja e cilësisë “të mjaftueshme” do të ishte e përzbulueshme ose tejet e kushtueshme.

5. Masat sipas pikës 4, germa “a”, ushtrohen:

- a) për nënpikën “i”, nga pushteti vendor,
- b) për nënpikën “ii”, nga ISSH-ja,
- c) për nënpikën “iii”, nga pushteti vendor dhe MPPT-ja,
- d) për nënpikën “iv”, nga pushteti vendor dhe ISSH-ja.

Neni 8

Profilet e ujërave të larjes

1. Pas fillimit të sezonit të parë të larjes pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, ISSH-ja përcakton profilet e ujërave të larjes sipas shtojcës III. Çdo profil mund të mbulojë një ose më shumë ujëra të larjes nëse këta përputhen.

2. Profilet e ujërave të larjes rishikohen dhe përditësohen çdo vit para fillimit të sezonit të larjes, siç parashikohen në shtojcën III.

3. Kur përcaktohen, rishikohen dhe përditësohen profilet e ujërave të larjes, përdoren edhe të dhënat e përftuara nga monitorimet dhe vlerësimet e realizuara sipas direktivës 76/160/KEE.

Neni 9

Masat administruese në rrethana të jashtëzakonshme

ISSH-ja i rekomandon pushtetit vendor masat e duhura administruese sapo vihet në dijeni të situatave të papritura, të cilat kanë ose arsyetohet se mund të kenë një ndikim negativ mbi cilësinë e ujërave të larjes dhe mbi shëndetin e personave që lahen në to. Pushteti vendor siguron marrjen në kohë të këtyre masave, që përfshijnë informimin e publikut dhe, nëse është e nevojshme, ndalimin e përkohshëm të larjes.

Neni 10

Rreziqet nga cianobakteriet

1. Në rast se profili i ujit të larjes tregon një tendencë për shumëzim të cianobakterieve, ISSH-ja ndërmerr një monitorim të përshtatshëm për të mundësuar identifikimin në kohë të rreziqeve shëndetësore.

2. Në rast se verifikohet një shumëzim i cianobakterieve dhe identifikohet apo supozohet një rrezik për shëndetin, autoritet kompetente ndërmarrin menjëherë masat e duhura administruese për të parandaluar ekspozimin ndaj rrezikut të personave që lahen në ujërat e larjes, sipas nenit 3, pika 13, germa “f”, “g”, “h”, “i” e “j”.

3. Masat sipas pikës nenit 3, pika 13, ushtrohen:

- i) për germën “f”, nga ISSH-ja;
- ii) për germën “g”, nga ISSH-ja dhe pushteti vendor;
- iii) për germën “h”, nga pushteti vendor;
- iv) për germën “i” dhe “j”, nga pushteti vendor dhe MPPT-ja.

Neni 11

Parametra të tjerë

1. Në rast se profili i ujit të larjes tregon një tendencë për shumëzim të makroalgave ose fitoplanktonit detar, Inspektorati Sanitar Shtetëror kryen observime për të përcaktuar shkallën e pranueshmërisë së tyre dhe rreziqet për shëndetin. Autoritetet kompetente ndërmarrin masat administruese sipas nenit 3, pika 13, germa “f”, “g”, “h”, “i” e “j”.

2. Inspektorati Sanitar Shtetëror kryen inspektimin vizual të ujërave të larjes për të dalluar ndotje, si: mbetje bituminoze, materiale xhami, plastike, gome dhe mbetje të tjera. Në rast se vërehen ndotje të tilla, autoritetet kompetente ndërmarrin masat e duhura administruese sipas nenit 3, pika 13, germa “f”, “g”, “h”, “i” e “j”.

3. Masat sipas nenit 3, pika 13, ushtrohen:

- i) për germën “f”, nga ISSH-ja;
- ii) për germën “g”, nga ISSH-ja dhe pushteti vendor;
- iii) për germën “h”, nga pushteti vendor;
- iv) për germën “i” dhe “j”, nga pushteti vendor dhe MPPT-ja.

Neni 12

Bashkëpunimi për ujërat ndërkufitare

Kur një basen lumor ndikon në cilësinë e ujërave ndërkufitare të larjes, ISSH-ja, IM-ja dhe pushteti vendor të përfshira, bashkëpunojnë në mënyrën më të përshtatshme për implementimin e kësaj rregulloreje, edhe nëpërmjet shkëmbimit të duhur të informacionit dhe veprimit të përbashkët për të vënë në kontroll dhe kufizuar këto ndikime.

KAPITULLI III SHKËMBIMI I TË DHËNAVE

Neni 13

Pjesëmarrja e publikut

1. Autoritetet kompetente, secila sipas kompetencës së vet, inkurajojnë pjesëmarrjen e publikut në zbatimin e kësaj rregulloreje dhe sigurojnë që publikut të interesuar i është dhënë mundësia:

- i) për t'u informuar mbi procesin e pjesëmarrjes; dhe
- ii) për të shprehur sugjerime, vërejtje apo ankesa.

Kjo ka të bëjë, në veçanti, me përgatitjen, rishikimin dhe përditësimin e listës së ujërave të larjes sipas nenit 5, pika 1. Autoritetet kompetente marrin në konsideratë çdo të dhënë të siguar.

2. Ministria e Shëndetësisë informon publikun nëpërmjet faqes së saj të internetit duke përdorur informacionin dhe të dhënat e dërguara nga ISSH-ja.

3. MMPAU-ja përditëson dhe publikon në faqen e saj të internetit të dhënat e informacionit mjedisor për zonat e larjes të vendit.

4. Me qëllim integrimin e të dhënave shëndetësore lidhur me ujërat e larjes dhe të dhënave mjedisore për programet e përmirësimit, me urdhër të përbashkët të Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, përcaktohen format e përbashkëta për trajtimin e të dhënave në zotërim nga secila administratë dhe sigurimin e reklamave.

Neni 14

Informimi i publikut

1. Autoritetet kompetente, secili sipas kompetencës së vet, sigurojnë që të dhënat e mëposhtme të shpërndahen në mënyrë aktive dhe të vihen menjëherë në dispozicion gjatë sezonit të larjes në një vend të dukshëm, sa më afër secilit ujë të larjes:

a) klasifikimin aktual të ujërave të larjes dhe çdo ndalim të larjes, sipas kësaj rregulloreje, me anë të një tabele apo simboli të qartë dhe të thjeshtë;

b) një përshkrim të përgjithshëm të ujërave të larjes, në një gjuhë joteknike, bazuar në profilin e ujërave të larjes të përcaktuar sipas shtojcës III;

c) në rastin e ujërave të larjes që rrezikohen nga ndotje afatshkurtër:

i) njoftimi që bën të ditur se uji në fjalë rrezikohet nga ndotje afatshkurtër;

ii) numri i ditëve në të cilat larja është ndaluar gjatë sezonit paraprirës për shkak të një ndotjeje të tillë;

iii) paralajmërim i menjëhershëm i ndotjes, të parashikuar apo prezente, me ndalim të përkohshëm të larjes;

d) informacion mbi natyrën dhe kohëzgjatjen e pritshme të situatave jonormale gjatë ngjarjeve sipas nenit 3, pika 21, germa "a";

e) sa herë që larja është ndaluar, informohet publiku me të gjitha mjetet e mënyrat e efektshme të komunikimit dhe paraqiten arsyet e ndalimit të larjes;

f) sa herë që paraqitet një ndalim i përhershëm i larjes, një njoftim që zona në fjalë nuk përbën më një zonë për larje, si dhe arsyet për heqjen e saj nga lista;

g) një tregues i burimeve nga ku merren informacione më të plota sipas pikës 2.

2. Pushteti vendor, sipas sugjerimeve të MSH-ISSH, përdor mënyra dhe teknologji të përshtatshme komunikimi, përfshirë edhe internetin, për të shpërndarë në mënyrë aktive dhe menjëherë informacionet mbi ujërat e larjes, të përmendura në pikës 1, dhe gjithashtu, nëse është e nevojshme, informacionet e mëposhtme, në gjuhë të ndryshme:

a) një listë të ujërave të larjes, vendndodhjen e tyre dhe kufizimet territoriale;

b) klasifikimin e secilit ujë të larjes gjatë tre viteve të kaluara dhe profilin përkatës, përfshirë rezultatet e monitorimit të kryer sipas kësaj rregulloreje pas klasifikimit të fundit;

c) masat për rehabilitim sipas nenit 3, pika 13, germa “j”;

d) në rastin e ujërave të larjes të klasifikuar si me cilësi “të keqe”, informacion mbi shkaqet e ndotjes dhe masat e marra me qëllim parandalimin e ekspozimit ndaj ndotjes të personave që lahen në to dhe trajtimin e shkaqeve të ndotjes siç përmendet në nenin 7, pika 4;

e) në rastin e ujërave të larjes, që janë objekt i ndotjes afatshkurtër, informacion i përgjithshëm mbi:

i) kushtet që pritet të çojnë në ndotjen afatshkurtër;

ii) shkalla e probabilitetit e një ndotjeje të tillë dhe kohëzgjatja e saj e pritshme;

iii) arsyet e ndotjes dhe masat e marra me qëllim parandalimin e ekspozimit ndaj ndotjes të personave që lahen në to dhe trajtimi i shkaqeve.

f) në rastin e ujërave të larjes që janë objekt i ndotjes sipas neneve 9, 10 e 11, informacion lidhur me rrezikun për njerëzit që lahen.

3. Lista sipas germës “a” të pikës 2, përditësohet dhe vihet në dispozicion çdo vit para fillimit të sezonit të larjes. Pas përfundimit të analizave, rezultatet e monitorimit sipas germës “b” të pikës 2, bëhen të disponueshme në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

4. Informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2, shpërndahet nëpërmjet faqes së internetit të Ministrisë së Shëndetësisë sapo të jetë i disponueshëm dhe ka efekt nga sezoni i pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Autoritetet kompetente, sa herë që është e mundur, informojnë publikun duke përdorur teknologjinë me gjeo-referim, duke e prezantuar atë në një mënyrë të qartë dhe koherente, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të shenjave dhe simboleve.

SHTOJCA I KËRKESAT E CILËSISË PËR UJËRAT E LARJES PARAMETRAT MIKROBIOLOGJIKË

Për ujërat e brendshme

Nr.	A. Parametri	B. Cilësi e shkëlqyer	C. Cilësi e mirë	D. Cilësi e mjaftueshme	E. Metodat analitike referencë
1	Enterokoki intestinal (cfu/100 ml)	200(*)	400(*)	330(**)	S SH ISO 7899-1 ose S SH ISO 7899-2
2	Escherichia coli (cfu/100 ml)	500(*)	1000(*)	900(**)	S SH ISO 9308-3 ose S SH ISO 9308-1

(*) Bazuar në vlerësimin e percentilës 95. Referoju shtojcës II.

(**) Bazuar në vlerësimin e percentilës 90. Referoju shtojcës II.

Për ujërat bregdetare dhe ujërat kalimtare

Nr.	A. Parametri	B. Cilësi e shkëlqyer	C. Cilësi e mirë	D. Cilësi e mjaftueshme	E. Metodat analitike referencë
1	Enterokoki intestinal (cfu/100 ml)	100(*)	200(*)	185(**)	S SH ISO 7899-1 ose S SH ISO 7899-2
2	Escherichia coli (cfu/100 ml)	250(*)	500(*)	500(**)	S SH ISO 9308-3 ose S SH ISO 9308-1

(*) Bazuar në vlerësimin e percentilës 95. Referoju shtojcës II.

(**) Bazuar në vlerësimin e percentilës 90. Referoju shtojcës II.

Parametrat fiziko-kimikë

Nr.	A. Parametri	G	I	Shpeshtësia minimale e marrjes së kampionit	Metoda e analizës dhe inspektimit
1	pH	-	6-9 (0)	(2)	Elektrometri me kalibrim në pH 7 dhe 9.
2	Ngjyrë	-	Pa ndryshim jonormal në ngjyrë (0)	Dy herë në muaj (1) (2)	Inspektimi vizual ose fotometri me standarde në shkallë Pt.Co.
3	Vajra minerale mg/litër	- ≤ 0.3	Pa cipë të dukshme në sipërfaqe të ujit dhe pa aromë -	Dy herë në muaj (1) (2)	Inspektim vizual dhe me nuhatje apo ekstraktim duke përdorur një vëllim të mjaftueshëm dhe duke peshuar mbetjen e thatë.
4	Lëndë sipërfaqësore aktive që veprojnë me blu metilen mg/l (Lauril sulfat)	- ≤ 0.3	Jo shkurme e qëndrueshme -	Dy herë në muaj (1) (2)	Inspektim vizual ose spektrofotometri absorbimi me blu metilen.
5	Fenole mg/l (treguesi i fenolit) C ₆ H ₅ OH	- ≤ 0.005	Jo aromë e veçantë ≤ 0.05	Dy herë në muaj (1) (2)	Verifikim i mungesës së aromës së veçantë nga fenoli ose metoda spektrofotometrisë me absorbim 4-aminoantipirinë (4 AAP).
6	Transparencë m	2	1 (0)	Dy herë në muaj (1)	Disku Secchi
7	Oksigjen i tretur % e ngopjes O ₂	80 - 120	-	(2)	Metoda Winkler ose metoda elektrometrike (oksigen metër).
8	Mbetje bituminoze dhe materiale pluskuese, si: dru, artikuj plastikë, shishe, enë qelqi, plastike, gome ose çdo lëndë tjetër. Plehra ose ashkla.	Të mos ketë	-	Dy herë në muaj (1)	Inspektim vizual.
9	Amoniaku mg/litër NH ₄	-	-	(3)	Spektro-fotometri absorbim, metoda Nessler, ose metoda blu indophenol.
10	Nitrogjen Kjeldahl mg/litër N	-	-	(3)	Metoda Kjeldahl

G = udhëzues, I = i detyrueshëm.

(0) Kapërcim i kufijve të parashikuar në rast të kushteve të veçanta gjeografike dhe gjeologjike.

1. Kur analizat e kampionëve në mbi dy vitet e fundit kanë rezultate, të cilat janë dukshëm më të mira se ato në këtë shtojcë dhe kur nuk ka asnjë faktor të ri që mund të ulë cilësinë e ujit, ISSH-ja mund të reduktojë shpeshtësinë e marrjes së kampionit me faktorin 2.

2. ISSH-ja kontrollon përqendrimin, kur një inspektim në zonën e largjes tregon se lënda mund të jetë e pranishme ose që cilësia e ujit është keqësuar.

3. Këta parametra duhet të kontrollohen nga ISSH-ja kur ka një tendencë drejt eutrofikimit të ujit.

SHTOJCA II

VLERËSIMI DHE KLASIFIKIMI I UJËRAVE TË LARJES

1. Cilësi e dobët

Ujërat e larjes klasifikohen të “cilësisë së dobët” nëse, në serinë e të dhënave të cilësisë së ujërave të larjes për periudhën e fundit të vlerësimit ^(a), vlerat percentile ^(b) të numërimeve mikrobiologjike janë më të ulëta ^(c) se vlerat që i korrespondojnë “cilësisë së mjaftueshme” të treguara në shtojcën I, kolona D.

2. Cilësi e mjaftueshme

Ujërat e larjes klasifikohen të “cilësisë së mjaftueshme”:

1. nëse, në serinë e të dhënave të cilësisë së ujërave të larjes për periudhën e fundit të vlerësimit, vlerat percentile të numërimeve mikrobiologjike janë të barabarta ose më të mira ^(d) se vlerat korresponduese të “cilësisë së mjaftueshme”, të treguara në shtojcën I, kolona D;

2. nëse ujërat e larjes janë objekt i ndotjes afatshkurtër, me kusht që:

i) janë marrë masat e duhura administruese, përfshirë survejancën, sistemet e alarmit të shpejtë dhe monitorimit, me qëllim parandalimin e ekspozimit të personave që lahen në to, me anë të një paralajmërimi ose, kur është e nevojshme, me anë të ndalimit të larjes;

ii) janë marrë masat e duhura administruese për parandalimin, reduktimin ose eliminimin e shkaqeve të ndotjes;

iii) numri i kampionëve të mosmarrë parasysht sipas nenit 5, pika 5, për shkak të ndotjes afatshkurtër gjatë periudhës së fundit të vlerësimit përfaqëson jo më shumë se 15% të numrit total të kampionëve të parashikuar në kalendarët e monitorimit, të caktuar për periudhën në fjalë, ose jo më shumë se një kampion për sezon larjeje, duke marrë në konsideratë gjithmonë vlerën më të lartë.

3. Cilësia e mirë

Ujërat e larjes klasifikohen të “cilësisë së mirë”:

1. nëse, në serinë e të dhënave të cilësisë së ujërave të larjes për vlerësimin e periudhës së fundit, vlerat percentile të numërimeve mikrobiologjike janë të barabarta ose më të mira ^(d) se vlerat korresponduese të “cilësisë së mirë”, të treguara në shtojcën I, kolona C;

2. nëse ujërat e larjes janë objekt i ndotjes afatshkurtër, me kusht që:

i) janë marrë masat e duhura administruese përfshirë survejancën, sistemet e alarmit të shpejtë dhe monitorimit, me qëllim parandalimin e ekspozimit të personave që lahen në to me anë të një paralajmërimi ose, kur është e nevojshme, me anë të ndalimit të larjes;

ii) janë marrë masat e duhura administruese për parandalimin, reduktimin ose eliminimin e shkaqeve të ndotjes;

iii) numri i kampionëve të mosmarrë parasysht sipas nenit 5, pika 5, për shkak të ndotjes afatshkurtër gjatë periudhës së fundit të vlerësimit përfaqëson jo më shumë se 15% të numrit total të kampionëve, të parashikuar në kalendarët e monitorimit të caktuar për periudhën në fjalë, ose jo më shumë se një kampion për sezon larjeje, duke marrë në konsideratë gjithmonë vlerën më të lartë.

4. Cilësia e shkëlqyer

Ujërat e larjes klasifikohen të “cilësisë së shkëlqyer”:

1. nëse, në serinë e të dhënave të cilësisë së ujërave të larjes për vlerësimin e periudhës së fundit, vlerat percentile të numërimeve mikrobiologjike janë të barabarta ose më të mira se vlerat korresponduese të “cilësisë së shkëlqyer” të treguara në shtojcën I, kolona B;

2. nëse ujërat e larjes i nënshtrohen ndotjes afatshkurtër, me kusht që:

i) janë marrë masat e duhura administruese përfshirë survejancën, sistemet e alarmit të shpejtë dhe monitorimit, me qëllim parandalimin e ekspozimit të personave që lahen në to me anë të një paralajmërimi ose, kur është e nevojshme, me anë të ndalimit të larjes;

ii) janë marrë masat e duhura administruese për parandalimin, reduktimin ose eliminimin e shkaqeve të ndotjes;

iii) numri i kampionëve të mosmarrë parasysih sipas nenit 5, pika 5, për shkak të ndotjes afatshkurtër gjatë periudhës së fundit të vlerësimit përfaqëson jo më shumë se 15% të numrit total të kampionëve, të parashikuar në kalendarët e monitorimit të caktuar për periudhën në fjalë, ose jo më shumë se një kampion për sezon larjeje, duke marrë në konsideratë gjithmonë vlerën më të lartë.

SHËNIME

(^a) “Periudha e fundit e vlerësimit” nënkupton katër sezonet e fundit të larjes ose, kur është e zbatueshme, periudhën e specifikuar në nenin 6 pika 2 ose 5.

(^b) Bazuar në vlerësimin e percentilës të funksionit normal të dendësisë të probabilitetit \log_{10} për të dhënat mikrobiologjike, të përfuara në një ujë të caktuar të larjes, vlera e percentilës përcaktohet si më poshtë:

i) merret vlera e \log_{10} nga të gjitha numërimet bakteriale në sekuencën e të dhënave të vlerësuar. (Nëse vlera është zero, në vend të saj merret vlera e \log_{10} për kufirin minimal të diktimit të metodës analitike të përdorur.);

ii) llogaritet e mesmja aritmetike e vlerave \log_{10} (μ);

iii) llogaritet deviacioni standard i vlerave \log_{10} (σ);

Pjesa e sipërme e percentilës 90 të funksionit të dendësisë së probabilitetit të të dhënave, nxirret me anë të ekuacionit të mëposhtëm:

Pjesa e sipërme e percentilës 90 = antilog ($\mu + 1.282 \sigma$).

Pjesa e sipërme e percentilës 95 të funksionit të dendësisë së probabilitetit të të dhënave, nxirret me anë të ekuacionit të mëposhtëm:

Pjesa e sipërme e percentilës 95 = antilog ($\mu + 1.65 \sigma$).

(^c) “më e keqe” nënkupton vlera më të larta të përqendrimit, e shprehur në cfu/100 ml.

(^d) “më e mirë” nënkupton vlera më të ulëta të përqendrimit, e shprehur në cfu/100 ml.

SHTOJCA III PROFILI I UJËRAVE TË LARJES

1. Profili i ujërave të larjes sipas nenit 8 përmban:

a) përshkrimin e karakteristikave fizike, gjeografike dhe hidrologjike të ujërave të larjes dhe të ujërave të tjera sipërfaqësore në pellgun ujëmbledhës të ujërave në fjalë, të cilat mund të jenë burim ndotje, karakteristika që lidhen me qëllimin e kësaj rregulloreje dhe siç parashikohet në direktivën 2000/60/KE;

b) identifikimin dhe vlerësimin e shkaqeve të ndotjes, të cilat mund të ndikojnë mbi ujërat e larjes dhe dëmtojnë shëndetin e personave që lahen në to;

c) vlerësimin e mundësisë për shumëzimin e cianobakterieve;

d) vlerësimin e mundësisë për shumëzimin e makro-algave dhe/ose fitoplanktonit;

e) në rast se vlerësimi sipas pikës “b” tregon prezencën e rrezikut të ndotjes afatshkurtër, të dhënat e mëposhtme:

- natyra, shpeshhtësia dhe kohëzgjatja e pritshme e ndotjes afatshkurtër të parashikuar;

- informacion i detajuar mbi çdo shkak të mbetur të ndotjes, përfshirë masat administruese të marra dhe afatet kohore të eliminimit të këtyre shkaqeve;

- masat administruese të marra gjatë ndotjes afatshkurtër, si dhe identiteti dhe adresa e organeve përgjegjëse për marrjen e këtyre masave;

f) vendndodhja e pikës së monitorimit.

2. Nëse ujërat e larjes janë klasifikuar si ujëra të cilësisë “e mirë”, “e mjaftueshme” ose “e dobët”, profili i ujërave duhet të rishikohet periodikisht, për të vlerësuar nëse ndonjë nga aspektet e renditura në pikën 1 ka ndryshuar, dhe nëse po, duhet të përditësohen të dhënat. Shpeshhtësia dhe shtrirja e rishikimit varen nga natyra dhe serioziteti i ndotjes. Megjithatë, rishikimi duhet të pajtohet të paktën me dispozitat e tabelës së mëposhtme dhe të kryhet me shpeshhtësinë e treguar në të.

Klasifikimi i ujërave të larjes: Cilësia	“e mirë”	“e mjaftueshme”	“e dobët”
Rishikimet do të kryhen të paktën çdo	4 vjet	3 vjet	2 vjet
Çështjet për t'u rishikuar (germat e pikës 1)	nga “a” në “f”	nga “a” në “f”	nga “a” në “f”

Në rastin e ujërave të larjes të klasifikuar më parë të “cilësisë së shkëlqyer”, profili i ujërave të larjes duhet të rishikohet dhe të përditësohet nëse është e nevojshme, vetëm nëse klasifikimi ka ndryshuar në “i mirë”, “i mjaftueshëm” ose “i dobët”. Rishikimi duhet të mbulojë të gjitha aspektet e përmendura në pikën 1.

3. Nëse janë kryer punimeve ndërtimi ose janë bërë ndryshime të rëndësishme në infrastrukturën e ujërave të larjes apo në afërsi të tyre, profili i ujërave të larjes duhet të përditësohet para fillimit të sezonit të ardhshëm të larjes.

4. Informacioni sipas pikës 1, gerrat “a” dhe “b”, duhet të paraqiten në një hartë të detajuar sa herë që të jetë e mundur.

5. Nëse autoritetet kompetente e gjejnë të arsyeshme, mund të bashkëngjiten ose përfshihen informacione të tjera të përshtatshme.

SHTOJCA IV MONITORIMI I UJËRAVE TË LARJES

1. Pak para fillimit të çdo sezoni larjeje, duhet të merret një kampion. Duke marrë në konsideratë këtë kampion ekstra dhe kërkesën sipas pikës 2, në çdo sezon larje do të merren dhe analizohen jo më pak se 4 kampionë.

2. Megjithatë, për çdo sezon larjeje, nevojiten të merren dhe analizohen vetëm tre kampionë në rastin e ujërave të larjes:

- a) me një sezon larje që nuk kalon 8 javë; ose
- b) ndodhet në një rajon që është objekt i kufizimeve të veçanta gjeografike.

3. Datat e marrjes së kampionëve shpërndahen përgjatë sezonit të larjes me intervale ndërmjet këtyre datave që kurrë nuk kalojnë një muaj.

4. Në rastin e ndotjes afatshkurtër, merret një kampion shtesë për të konfirmuar se incidenti ka përfunduar. Ky kampion nuk duhet të jetë pjesë e serisë së të dhënave të cilësisë së ujërave të larjes. Nëse nevojitet që të zëvendësohet një kampion i skartuar, duhet të merret një kampion shtesë 7 ditë pas përfundimit të ndotjes afatshkurtër.

SHTOJCA V METODOLOGJIA E MARRJES SË KAMPIONIT DHE ANALIZAVE MIKROBIOLOGJIKE

1. Marrja e kampionit

Aty ku është e mundur, kampionët merren 30 centimetra nën sipërfaqen e ujit dhe në ujëra që janë të paktën 1 metër të thella.

2. Shishet/kontejnerët për kampionët e ujit të larjes:

a) Kampionët mblidhen në shishe/kontejnerë që janë sterilizuar me anë të njëjës prej procedurave të mëposhtme:

- sterilizim në autoklavë për të paktën 15 minuta në 121°C; ose
- sterilizim i thatë për të paktën një orë, në një temperaturë ndërmjet 160°C dhe 170°C; ose
- shishe/kontejnerë të rrezatuar drejtpërdrejt nga prodhuesi.

b) Vëllimi i shishes/kontejnerit për marrjen e kampionit varet nga sasia e ujit, e nevojshme për të analizuar secilin parametër. Në përgjithësi, vëllimi minimal është 250 ml.

c) Shishet/kontejnerët e marrjes së kampionëve duhet të jenë të tejdukshëm dhe pa ngjyrë (qelq, polietilen ose polipropilen).

d) Me qëllim parandalimin e ndonjë ndotjeje aksidentale të kampionit, personi që e merr kampionin përdor teknika aseptike për të ruajtur sterilitetin e shisheve/kontejnerëve të kampionëve. Në rast se marrja e kampionit realizohet sipas procedurës së duhur, nuk është nevoja për pajisje sterile të tjera (si doreza sterile kirurgjikale, pinceta apo tuba).

e) Kampioni duhet të identifikohet qartësisht me bojë që nuk del në shishe/kontejner dhe në formularin shoqërues të saj.

3. Ruajtja dhe transportimi i kampionve para analizës

a) Gjatë të gjitha fazave të transportit, kampionët e ujit duhet të mbrohen nga ekspozimi ndaj dritës, veçanërisht ndaj dritës së drejtpërdrejtë të diellit.

b) Kampionët duhet të ruhen në një temperaturë rreth 4°C, në një kuti termale ose frigorifer (në varësi të motit) deri në mbërritjen në laborator. Në rast se transporti deri në laborator ka të ngjarë të zgjasë më shumë se 4 orë, atëherë është i detyrueshëm transporti i kampionit në një frigorifer.

c) Koha ndërmjet marrjes së kampionëve dhe analizës së tyre duhet të jetë sa më shkurtër që të jetë e mundur. Rekomandohet që kampionët të analizohen në të njëjtën ditë pune në të cilën janë marrë kampionët. Nëse për arsye praktike, një gjë e tillë është e pamundur, atëherë kampionët përpunohen brenda jo më shumë se 24 orëve. Ndërkohë, kampionët ruhen në një vend të errët në një temperaturë prej 4°C ±3°C.

4. Metodat analitike referencë

Me qëllim përcaktimin e pranisë së enterokokit intestinal, metodat analitike referencë janë:

S SH ISO 7899-1: Cilësia e ujit. Zbulimi dhe numërimi i enterokokit intestinal në ujërat sipërfaqësore dhe ujërat e ndotura – pjesa 1: Metoda e miniaturizuar (numri më i mundshëm-mpn) për ujërat sipërfaqësore dhe ujërat e ndotura.

S SH ISO 7899-2: Cilësia e ujit. Zbulimi dhe numërimi i enterokokit intestinal në ujërat sipërfaqësore dhe ujërat e ndotura – pjesa 2: Metoda e filtrimit me membranë.

Me qëllim përcaktimin e pranisë së escherichia coli, metodat analitike referencë janë:

S SH ISO 9308-1: Cilësia e ujit. Zbulimi dhe numërimi i E-coli dhe bakteria koliforme – pjesa 1: Metoda e filtrimit me membranë.

S SH ISO 9308-3: Cilësia e ujit. Zbulimi dhe numërimi i E-coli dhe bakteria koliforme në ujërat sipërfaqësore dhe ujërat e ndotura – pjesa 3: Metoda e minimizuar (numri më i mundshëm - mpn) duke e futur në terren të lëngshëm.

VENDIM

Nr.846, datë 27.10.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.862, DATË 5.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR UNIFIKIMIN E PROCEDURAVE TË KONTROLLIT TË TERRITORIT NGA INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR E AI VENDOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pas pikës 20 të vendimit nr.862, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 20/1, me këtë përmbajtje:

“20/1. Formularët bashkëlidhur këtij vendimi e që janë pjesë përbërëse e tij, në emërtesat përkatëse, si më poshtë vijon:

8010

- a) procesverbal për konstatimin e shpenzimeve të prishjes;
 - b) vendim për zhdëmtimin e shpenzimeve të prishjes e të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme;
 - c) procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes për mjetet dhe makineritë;
 - ç) vendim për dënim me gjobë për mjetet dhe makineritë;
 - d) procesverbal për sekuestrimin e mjeteve e të makinerive;
 - dh) vendim për sekuestrimin e mjeteve e të makinerive.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK _____

NR. _____

PROCES-VERBAL
(PËR KONSTATIMIN E SHPENZIMEVE TË PRISHJES)

I mbajtur më dt. ___/___/___, nga inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik _____,
në subjektin juridik/fizik _____,
me adresë _____, pas ekzekutimit
të vendimit për prishje nr. _____, dt. ___/___/___, me nr.serie _____, u
konstatua:

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin/nenet _____, të ligjit Nr.9780,
dt. 16.07.2007 “ Për inspektimin e ndërtimit”, u mbajt ky proces-verbal dhe subjekti i kontrolluar
(pranon të nënshkruaj _____, nuk pranon të nënshkruaj _____, nuk i njihet identitetit _____)

Inspektorët

Subjekti i kontrolluar

1. _____

2. _____

3. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK _____

NR. _____

VENDIM

Nr. _____, Datë ____/____/_____

(PËR ZHDËMTIMIN E SHPENZIMEVE TË PRISHJES DHE K'THIMIT TË TRUALLIT NË
GJENDJEN E MËPARSHME)

Në bazë të Proces-Verbalit Nr. _____ dt. ____/____/_____, me nr. serie _____, të mbajtur nga inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik _____, në subjektin juridik/ fizik _____, ka rezultuar se është kryer kundërvajtja _____, e parashikuar në nenin/et _____, e ligjit Nr. _____, datë ____/____/_____, " _____ " „

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin/et _____, të ligjit nr.9780, dt.16.07.2007 " Per inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar,

VENDOSA:

Zhdëmtimin për shpenzimet e prishjes në masën _____, ndaj kundërvajtësit _____, me adresë: _____.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë, brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi gjyqësor kundër këtij vendimi, nuk pezullon ekzekutimin e tij.

KRYEINSPEKTORI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK _____

NR. _____

PROCES-VERBAL
(PËR KONSTATIMIN E KUNDËRVAJTJES PËR MJETET DHE MAKINERITË)

I mbajtur më dt. __/__/__, nga inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik _____

në subjektin juridik/fizik _____,

me adresë: _____.

Gjatë ushtrimit të kontrollit u konstatua përdorimi i mjeteve dhe makinerive të mëposhtme:

_____.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin/et _____, të ligjit Nr. 8405, dt. 17.09.1998, "Për urbanistikën " i ndryshuar, u mbajt ky proces-verbal dhe subjekti i kontrolluar _____

(pranon të nënshkruaj _____, nuk pranon të nënshkruaj _____, nuk i njihet identitetit _____)

Inspektorët

Subjekti i kontrolluar

1. _____

2. _____

3. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK _____

NR. _____

VENDIM
(PËR DËNIM ME GJOBË PER MJETET DHE MAKINERITË)

Nr. _____, Datë ____ / ____ / _____

Në bazë të Proces-Verbalit Nr. _____ dt. ____ / ____ / _____, me nr. serie _____, të mbajtur nga inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik _____, në subjektin juridik/ fizik _____, ka rezultuar se është kryer kundërvajtja _____, e parashikuar në nenin/et _____, të ligjit Nr. 8405, dt. 17.09.1998, "Për urbanistikën " i ndryshuar,

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin/et _____, të ligjit Nr. 8405, dt. 17.09.1998, "Për urbanistikën " i ndryshuar,

VENDOSA:

Dënimin me gjobë në masën _____, ndaj kundërvajtësit _____ me adresë _____.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë, brenda 10 ditëve duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi gjyqësor kundër këtij vendimi, nuk pezullon ekzekutimin e tij.

KRYEINSPEKTORI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK _____

NR. _____

PROCES-VERBAL
(PËR SEKUESTRIMIN E MJETEVE DHE MAKINERIVE)

I mbajtur më dt. ___/___/___, nga inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik _____

në subjektin juridik/fizik _____

me adresë: _____

Gjatë ushtrimit të kontrollit u sekuestruan mjetet dhe makineritë e mëposhtme:

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin ____, të ligjit Nr. 8405, dt. 17.09.1998, "Për urbanistikën " i ndryshuar, u mbajt ky proces-verbal dhe subjekti i kontrolluar _____
(pranon të nënshkruaj ____, nuk pranon të nënshkruaj ____, nuk i njihet identiteti _____)

Inspektorët

Subjekti i kontrolluar

1. _____

2. _____

3. _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI NDËRTIMOR E URBANISTIK _____

NR. _____

VENDIM
(PËR SEKUESTRIMIN E MJETEVE DHE MAKINERIVE)

Nr. _____, Datë ____/____/____

Në bazë të Proces-Verbalit Nr. _____ dt. ____/____/____, me nr. serie _____, të mbajtur nga inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik _____, në subjektin juridik/ fizik _____, ka rezultuar se është kryer kundërvajtja _____

_____ ,
e parashikuar në nenin/et _____, të ligjit Nr. 8405, dt. 17.09.1998, "Për urbanistikën " i ndryshuar,

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin/et _____, të ligjit Nr. 8405, dt. 17.09.1998, "Për urbanistikën " i ndryshuar,

VENDOSA:

Sekuestrimin _____,
ndaj kundërvajtësit _____,
me adresë _____.

Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë, brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi gjyqësor kundër këtij vendimi, nuk pezullon ekzekutimin e tij.

KRYEINSPEKTORI

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 9.11.2010

Doli nga shtypi më 11.11.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 24 lekë